

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	107 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/107-dite-revolte-qytetaret-nuk-e-ndalin-rezistencen-oshetin-bulevar-i514133
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 18:02:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 17:57:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8088b281fbeab47d520b1bdbbab30a14ac9316d94d985b76be7ceb59bba73849
TEKSTI	f805496085b62fc8853863fe9e78e46e26231621a27e1f331281e4a7410bb199
PAMJA	4e8a731a987796a8f38674466d96715285d94739519957519ffbd662200e2b63

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f15bf9b44bc172c87cc580f1be9f0a04fea8945c1dde5a095144c668e461caaf
E MËPARSHMJA	e2a5d163052c45d2b555546efa063bd45ccf6bc02c7c9dd6677e31ac97904ec2
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/f15bf9b44bc172c87cc580f1be9f0a04fea8945c1dde5a095144c668e461caaf

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

3 ORE ME PARE

107 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion

3 ORE ME PARE

Më 16 shtator jepet vendimi për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-së/ Kurti: Uroj të kthehen të lirë. Ambasada e SHBA në Prishtinë: Priten protesta, kini kujdes

8 ORE ME PARE

"Në epiqendër të takimeve ishte narkoshteti"/ Berisha pas kthimit në SHBA: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës!

11 ORE ME PARE

Protestë te Zogu i Zi/ Shoqërohen 10 qytetarë nga policia, disa prej tyre dhunohen me grushta

LIVE UPDATES

107 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion

• Protestuesit janë mbledhur sot në protestën e 107-të radhazi për largimin e Kryeministrit Edi Rama. • Fillimisht qytetarët janë mbledhur në Sheshin "Skënderbej" dhe më pas kanë marshuar drejt kryeministrit, aty ku dhe kanë mbajtur fjalimet e tyre. • Protestuesit kërkojnë ndryshim të gjithë klasës politike, mesazh të cilën e kanë përcjellë prej 107 ditësh me thirrjen "Rama në burg, Berisha në burg". • Pavarësisht 107 ditëve të protestave, protestuesit deklarojnë se nuk do të tërhiqen dhe se do të vijojnë qëndresën deri në realizimin e kërkesave të tyre. • Pas përfundimit të fjalimeve para Kryeministrit, qytetarët kanë vijuar marshimin rrugëve të kryeqytetit. • Marshimi u ndal fillimisht pranë Bllokut të Sigurisë, në rrugën "Mine Peza", ku protestuesit shprehën mbështetjen e tyre për personat e ndaluar gjatë protestave. • Më pas, turma u zhvendos në drejtim të Prokurorisë së Tiranës, ku protestuesit vijuan me thirrjet e tyre dhe përcollën mesazhet kundër qeverisë. • "Arrestoni Ramën", "O Ergys o legen prite Ramën se po vjen", "Edi Rama frikacak", "Dorëheqje, ju erdhi fundi", "Policia e krimit", "Edi Rama jep dorëheqjen", "Edi Rama në burg", "O Erion o legen prite Ramën se po vjen", "Shqipëria e shqiptarëve, vdekje tradhtarëve", "Pa rini nuk ka Shqipëri", "Poshtë patronazhistët" dhe "Shqipëria kërkon revolucion", janë disa nga thirrjet kryesore që protestuesit kanë brohoritur në kor gjatë tubimit.

6 artikuj për këtë temë.

3 MINUTA ME PARE

Mbyllet protesta e 107-të, qytetarët thirrje në kor: Rama jepe dorëheqjen



pamjet

TIRANË- Ka përfunduar protesta e 107-të e qytetarëve. Protesta e kësaj të hëne u shoqërua me thirrje të forta kundër kryeministrit Edi Rama dhe qeverisë së tij. "Rama jep dorëheqjen" ishte thirrja që u përsërit gjatë protestës.

Në fjalimet e mbajtura para Kryeministrit, protestuesit kërkuar largimin e qeverisë, ndërsa u ngritën edhe shqetësime për situatën politike në vend. Një prej kërkesave të protestuesve ishte edhe liriimi i protestuesve të arrestuar, ndërsa nga podiumi u përsëritën thirrjet kundër qeverisë.

Gjatë marshimit në rrugët e kryeqytetit, protestuesit janë ndaluar edhe te Blloku i Sigurisë, ku kanë kërkuar liriimin e protestuesve dhe kanë vijuar me thirrjet kundër qeverisë dhe kryeministrit Edi Rama.

Pas përfundimit të fjalimeve dhe marshimit në rrugët e kryeqytetit, qytetarët kanë mbyllur protestën e 107-të, ndërsa kanë paralajmëruar rezistencë deri në largimin e Ramës dhe qeverisë së tij./Dosja.al

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 22:25

Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Reuters: Vendimi mund të trondisë raportet e Kosovës me Perëndimin

24 MINUTA ME PARE


107 ditë revoltë! Qytetarët nuk heqin dorë, marshojnë rrugëve të Tiranës: Polici këtu na ke, ti mbron krimin dhe jo ne(VIDEO)



pamjet

TIRANË- Marshimi i qytetarëve nëpër Tiranë vijon në kuadër të protestës së ditës së 107-të kundër qeverisë, ndërsa protestuesit shoqërojnë lëvizjen me thirrje kundër Policisë së Shtetit.

"Polici, këtu na ke, ti mbron krimin dhe jo ne", "Polici pse dhunon?" janë ndër thirrjet që po përsëriten nga protestuesit gjatë marshimit.



Marshimi u ndal fillimisht pranë Bllokut të Sigurisë, në rrugën "Mine Peza", ku protestuesit shprehën mbështetjen e tyre për personat e ndaluar gjatë protestave. Më pas, turma u zhvendos në drejtim të Prokurorisë së Tiranës, ku protestuesit vijuan me thirrjet e tyre dhe përcollën mesazhet kundër qeverisë.

Protestuesit deklarojnë se nuk do të tërhiqen dhe se do të vijojnë protestat, ndërsa dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama e konsiderojnë një nga kërkesat kryesore dhe të panegociueshme të lëvizjes./Dosja.al

3 ORE ME PARE

"Nuk kanë forca të menaxhojnë situatën në bulevard"/ Protestuesi: Frontin nuk do e

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 20:09

Vrasja e Franc Konomit, flasin familjarët e tij/ Gruaja: Hotelin ia mori vëllai dhe ia shiti. I biri: Kanë dashur të më vrasin edhe mua dy herë

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 15:41

"Mbaje mend do të vras"/ Kërcënohet me vdekje gazetari Osman Stafa, Policia: Materialet u referuan në Prokurori për 3 vepra penale

më të klikuarat



"Të q***a robt, o Edi"/ Rama kap të riun nga qafa dhe ia dorëzon policisë, çfarë ndodhi në Aeroportin e Napolit? (VIDEO)

"Mbaje mend do të vras"/ Kërcënohet me vdekje gazetari Osman Stafa, Policia: Materialet u referuan në Prokurori për 3 vepra penale

Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë të lartë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën në Pediatri të QSUT-së: Prindërit përballen me arrogancë dhe poshtërim

Ilir Meta del nga kafazi/ Apeli i GJKKO pranon kërkesën: Gjatë seancave do qëndrojnë krah avokatit

insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E

lëshojmë, jemi afër fitores

TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"



Protestuesi

TIRANË- Një qytetar pjesëmarrës në tubimin përballë godinës së Kryeministrit në ditën e sotme, ka marrë fjalën e tij në podium ku ka treguar një incident të ndodhur në protestën e mëngjesit.

Ai ka treguar rastin e një oficeri të policisë i cili ka qëlluar me grusht në bark një protestues, dhe i ka bërë thirrje strukturave të policisë që të njihen me procedurat në mënyrë që të mos hedhin poshtë punën. Ai u ka kërkuar qytetarëve që të ruajnë qetësinë dhe të mos e lëshojnë frontin sepse, sipas tij, janë shumë pranë fitores.

"Sot dua të theksoj një moment shumë delikat. Në momentin kur po shoqërohej një person, vjen polici dhe godet në mënyrë brutale. Ky person i keqformuar, hedh poshtë punën. Nëse me syrin tuaj do e kishit parë, kjo është shkelje e të gjitha normave. I bëj thirrje strukturave të policisë, të njihen mirë me procedurat dhe taktikat.

Secili person do bëjë kallëzimin në organet kompetente. Unë e di shumë mirë që juve nuk iu kanë paguar. E di mirë që ju keqtrajtojnë, ju kërkoj sidomos policëve të vjetër që kanë përvojë, të jenë të përmbytur.

Nuk po kanë forca të menaxhojnë një situatë në bulevard, lërë më të përballen me krimin e organizuar. Ruani qetësinë dhe zbatoni ligjin, frontin nuk do e lëshojmë. Shqisa ime e gjashtë më thotë se jemi afër fitores", shprehet ai./Dosja.al

3 ORE ME PARE

"Shqipëria është në udhëkryq" / Protestuesi: Antishqiptari me emrin Edi Rama po bën ligje që vënë në rrezik territorin



TIRANË- Protesta në Tiranë shënon sot 107 ditë të revoltës qytetare. Një qytetar, pjesëmarrës në protestë, ka marrë fjalën e tij në podium ku është shprehur se kombi është në rrezik, ndaj shqiptarët duhet të bëhen bashkë.

Në fjalën e tij, ai e ka cilësuar kryeministrin e vendit Edi Rama si 'antishqiptar' i cili bën ligje që vënë në rrezik territorin. Ai ka shprehur njëkohësisht, pakënaqësitë në lidhje me pagat e punonjësve, pensionet dhe ka theksuar se në 107 ditë protestë

Moti

Powered by tomorrow.

janë treguar paqësor dhe të emancipuar.

Në fund të fjalës së tij, protestuesi ka kërkuar të shmangen provokimet nga forcat policore, ku ka përmendur edhe rastin e një oficeri që ka qëlluar me grusht në bark një protestues gjatë protestës së organizuar këtë mëngjes.

"Shqiptarët bëhen bashkë për të shpëtuar kombin, kombi është në rrezik. Antishqiptari me emrin Edi Rama po bën ligje që vënë në rrezik territorin. Ligje si paketa e maleve, investitori strategjik, çënon vendin. Shqipëria është në udhëkryq, kombi është në udhëkryq, ndaj duhet të jemi bashkë."

Sot SPAK doli me një deklaratë që ka një vilë të 3 sekrete të Ballukut. Ky është një krim...Pensionistët mezi paguajnë ilaçet dhe të rinjtë nuk blejnë dot një shtëpi...Policia e Shtetit me 600 mijë mëztor sigurojnë rritjen e fëmijëve...Studentët dje e demaskuan hajduten. Një polici qëlloi me grusht një protestues dhe shefi i tij bënte sehir. Ky është një turp. Durimi ka kufi dhe kemi treguar që jemi paqësor, popull i emancipuar. Mos na provokoni sepse revolta popullore kur të ndizet nuk ndalet më", tha ai./Dosja.al

3 ORE ME PARE

FOTOLAJM/ Pankarta pikante nga protesta e 107-të: Nafta si në Londër, rrogat si...



Pankarta

TIRANË- Protesta në Tiranë ka shënuar ditën e sotme 107 ditë të revoltës qytetare. Qytetarët kanë nisur si fillim grumbullimin në sheshin Skënderbej, dhe mas marshimin drejt godinës së Kryeministrit.

Këtë ditë, nuk kanë munguar as pankartat pikante të cilat i japin një mesazh qeverisë. "Nafta si në Londër, rrogat si në mjerim. Me taksat e karburantit, meritoni vetëm përçmim", "SPAK, të mos arrestohet populli që kërkon të vërtetën, të prangosen ata që na vjedhin shtetin dhe jetën" thuhet në disa pankarta./Dosja.al

3 ORE ME PARE

Nis dita e 107-të e protestës, thirrje: Arrestoni Ramën





Pamje nga marshimi i protestuesve drejt Kryeministritë, në ditën e 107-të

TIRANË- Protesta në Tiranë ka shënuar ditën e sotme 107 ditë të revoltës qytetare kundër klasës politike. Si çdo ditë, protestuesit kanë nisur fillimisht grumbullimin në sheshin Skënderbej për të vijuar më tej marshimin drejt godinës së Kryeministritë në të cilën do të mbahen fjalime nga organizatorët e protestët dhe të pranishmit.

Kërkesat e protestuesve mbeten dorëheqja e panegociueshme e kryeministrit të vendit Edi Rama, si dhe anulimi i ligjit për zonat e mbrojtura. Ditëve të fundit, tubimit i është bashkuar edhe diaspora shqiptare. Nën thirrjet 'Arrestoni Ramën', 'Nuk shitet Shqipëria', me pankarta e flamuj në duar qytetarët kanë vijuar për 107 ditë radhazi revoltën e tyre./**Dosja.al**

protesta kunder qeverise rama

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.